



KLAN KOSOVA
Baton HAXHIU
Drejtor
Prishtinë

Ankesa Nr. 2017/14 KPM vs KLAN KOSOVA
Ref:1708/791/KPM/am

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2017/14 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër KLAN KOSOVA (“Pala Përgjegjëse”)

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 12 shkurt 2009. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet nënligjore të miratuara nga KPM.
2. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datë 28 maj 2013, ka nxjerrë Rregulloren për të Drejtën e Autorit KPM-2013/02. Me këtë rregullore janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e shërbimeve mediale audiovizuale lidhur me respektimin e të drejtës së transmetimit dhe ritransmetimit.
3. KPM, me datën 23 shkurt 2017, ka pranuar një ankesë të parashtruar nga subjekti transmetues KTV lidhur me emisionin “Zona B” të transmetuar në Klan Kosova. Në ankesën e KTV-së theksohet se në emisionin “Zona B” të datës 22 shkurt 2017, është transmetuar pa të drejtë filmi dokumentar në gjuhën serbe “General Dikovic and 37th Brigade in Kosovo”. KTV ka siguruar një dokument nga Fondi për të Drejtën Humanitare, përmes të cilit ka siguruar të drejtat për transmetimin e dokumentarit.
4. KPM, me datën 7 mars 2017, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që në afat prej pesë (5) ditësh t’i ofrojë KPM-së sqarim në lidhje me ankesën dhe marrëveshjen për të drejtën e transmetimit të dokumentarit në fjalë.
5. Pala Përgjegjëse, me datën 8 mars 2017, i është përgjigjur kërkesës së KPM-së, duke mohuar se ka qenë në dijeni se ndonjë televizion tjetër posedon të drejtat për transmetimin e dokumentarit dhe duke sqaruar se transmetimi i dokumentarit është me interes të jashtëzakonshëm për publikun. KPM, gjithashtu ka gjetur se Pala Përgjegjëse i ka kërkuar falje publike Fondit për të Drejtat Humanitare për transmetimin e këtij dokumentari, pa ndonjë autorizim paraprak.
6. KPM bazuar në të gjeturat e raportit të monitorimit, me datën 20 mars 2017, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje, me të cilin e ka njoftuar për shkeljen e bërë dhe i

ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/02, duke mos transmetuar përmbajtje për të cilat nuk posedon të drejta të transmetimit.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1 të Rregullores KPM-2013/02.

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/02 përcakton se:

“Shërbimet mediale audiovizuale pavarësisht teknologjisë së përdorur për ofrimin e përmbajtjes audiovizuale, obligohen të bëjnë transmetimin dhe ritransmetimin e programeve bazuar në marrëveshjet e vlefshme për të drejtën e autorit.”


8. KPM ka gjetur se Pala Përgjegjëse i është përgjigjur kërkesës së KPM-së, duke ofruar sqarim lidhur me dokumentarin e transmetuar, mirëpo nuk ka deponuar marrëveshje për transmetimin e filmit dokumentar në gjuhën serbe “General Dikovic and 37th Brigade in Kosovo” të transmetuar nga Pala Përgjegjëse me datën 22 shkurt 2017. Bazuar në faktet e lartpërmendura, KPM ka gjetur se Klan Kosova ka vepruar kështu në kundërshtim me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02.
9. KPM, duke u bazuar në raportin e monitorimit gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02.

Vendimi

10. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02.
11. Komisioni, bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon me **Vërejtje** Palën Përgjegjëse për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02.

E drejta për Ankesë

12. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
13. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Adnan MEROVCI
Kryetar



10.08.2017
Datë